




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Nr.1, TIRANË
SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE SEKRETARIA**

Nr 151 Prot

Tiranë më, 02.02.2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; Udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Ofruesi publik i QFP **Qendra e Formimit Profesional Publik Nr.1, Tiranë**, ju njofton krijimin e vendeve të lira për:

-Instruktor i praktikës profesionale me kohë të pjesshme për kursin **Instalime dhe Mirëmbajtje e Rrjetit elektrik**- 1 Person.

-Instruktor i praktikës profesionale me kohë të pjesshme për kursin **Riparime Elektroshtëpiake**. –1 Person.

-Instruktor i praktikës profesionale me kohë të pjesshme për kursin **Reception**.–1 Person.

-Instruktor i praktikës profesionale me kohë të pjesshme për kursin **Picajol** – 1 Person.

-Instruktor i praktikës profesionale me kohë të pjesshme për kursin **Estetikë**-1 Person.

-Instruktor i praktikës profesionale me kohë të pjesshme për kursin **Manikyr Pedikyr**-1 Person.

-Instruktor i praktikës profesionale me kohë të pjesshme për kursin **Kuzhinë-Prodhome Brumi**– 1 Person.

-Instruktor i praktikës profesionale me kohë të pjesshme për kursin **Kujdestar për Fëmijë**–1 Person.

-Instruktor i praktikës profesionale me kohë të pjesshme për kursin **AutoCAD** -1 Person.

-Instruktor i praktikës profesionale me kohë të pjesshme për kursin **Aftësi Digjitale**.–2 Persona.

-Instruktor i praktikës profesionale me kohë të pjesshme për kursin **Aftësi për punësim**–1 Person.

KRITERET E PËRGJITHSHME DHE KRITERET E POSAÇME

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin po aplikon;
- Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet
- Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.
- Aftësi të tjera nëse kërkohen.

II. DOKUMENTET E APLIKIMIT

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;

- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të QPF-së, brenda datës 11.02.2026.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të Udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të insititucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit, i ndryshuar.

DREJTOR

Hanëme MATA



Konceptoi: Lidja Karazi
Pranoi: Hanëme Mata
Nr. i kopjeve: 3 cope